

Në bazë të nenit 13 paragrafi 1 të Ligjit për Qendrën Shtetërore të Provimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 142/08, 148/09, 41/14, 55/16, 142/16 dhe 64/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 59/25) dhe nenit 5 paragrafi 1 nga Rregullore për mënyrën, procedurën dhe kriteret e përzgjedhjes së bashkëpunëtorëve të jashtëm të Qendrës Shtetërore të Provimeve nr.01-440/3 datë 28.12.2022, nr. 01-176/3 datë 1.3.2023 nr. 01-197/3 datë 15.4.2024, nr. 01-109/3 datë 11.2.2025 dhe nr. 01-157/4 të datës 25.3.2025, dhe Koncepti për provimet përfundimtar në arsimin e mesëm, viti 2025, Qendra Shtetërore e Provimeve, shpall

KONKURS PUBLIK

për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm – kryetarë dhe anëtarë të komisioneve lëndore të maturës shtetërore për nevojat e maturës shtetërore, maturës profesionale shtetërore, përkatësisht maturës artistike shtetërore, si dhe lexues të pavarur të materialit të provimit për nevojat e maturës artistike shtetërore për vitin shkollor 2025/2026

I. Qendra Shtetërore e Provimeve shpall konkurs publik për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm - kryetarë dhe anëtarë të komisioneve lëndore të maturës shtetërore për nevojat e maturës shtetërore, maturës shtetërore profesionale, përkatësisht maturës shtetërore artistike dhe lexues të pavarur të materialit të provimit për nevojat e maturës shtetërore artistike për vitin shkollor 2025/2026.

II. Konkursi publik shpallet për përzgjedhjen e:

- a) Bashkëpunëtorët e jashtëm – kryetarë dhe anëtarë të komisioneve lëndore të maturës shtetërore për lëndët:
1. **Gjuhë serbe** – 1 (një) kryetar dhe 2 (dy) anëtarë;
 2. **Gjuhë italiane** – 1 (një) kryetar dhe 2 (dy) anëtarë dhe
 3. **Histori** – 1 (një) kryetar dhe 2 (dy) anëtarë.
- b) Bashkëpunëtori i jashtëm – lexues i pavarur i materialit të provimit për lëndën:
1. **Histori** – 1 (një) lexues i pavarur.

III. Kushtet që duhet të plotësojnë kandidatët që konkurrojnë për konkursin publik dhe dokumentacioni i detyrueshëm që duhet të dorëzojnë.

a) Kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët që konkurrojnë në konkursin publik për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm – kryetarë dhe anëtarë të komisioneve lëndore të maturës shtetërore, si dhe dokumentacioni i detyrueshëm që ata duhet të dorëzojnë:

a.1) Kandidatët që konkurrojnë për **kryetarë të komisionit lëndor të maturës shtetërore** duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- të ketë përfunduar të paktën studime akademike të ciklit të dytë në fushën përkatëse;
- të jenë nga radhët e kuadrit mësimor-shkencor ose profesional nga universitetet në RMV në lëndën përkatëse, përkatësisht fushën përkatëse;
- të kenë të paktën 5 (pesë) vjet përvojë pune në veprimtari edukativo-arsimore ose shkencore dhe
- të kenë punime të botuara profesionale, përkatësisht shkencore që janë në funksion të fushës përkatëse.

Kandidatët që konkurrojnë për **kryetarë të komisionit lëndor të maturës shtetërore** duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

- formularin e aplikimit të plotësuar (formulari i aplikimit është i vendosur në faqen e internetit: www.dic.edu.mk);
- biografi e shkurtër;
- certifikatën e shtetësisë;
- një kopje të certifikatës/diplomës për studime të përfunduara akademike të ciklit të dytë në fushën përkatëse, e vërtetuar në noter;
- vërtetim për marrëdhënien e rregullt të punës së si pjesë e kuadrit mësimor-shkencor ose profesional të universiteteve në RMV në lëndën përkatëse, përkatësisht fushën përkatëse;
- vërtetim për së paku 5 (pesë) vite përvojë pune në veprimtari edukativo-arsimore ose shkencore, si dhe kopje të faqes së parë të punimeve profesionale, përkatësisht shkencore të publikuara, të cilat janë në funksion të fushës përkatëse.

a.2) Kandidatët që konkurrojnë për **anëtarë të komisioneve lëndore të maturës shtetërore**, duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- të kenë të përfunduar të paktën studime akademike të ciklit të parë në fushën përkatëse;
- të jenë nga radhët e individëve profesional-mësimdhënës të lëndës përkatëse në shkollat e mesme në RMV, por nëse nuk ka mësimdhënës të tillë të paraqitur, do të merren parasysh edhe mësimdhënësit e lëndës përkatëse në shkollat fillore në RMV;
- të kenë të paktën 7 (shtatë) vjet përvojë në mësimdhënie dhe
- të kenë të paktën 3 (tre) vjet përvojë në procesin e vlerësimit të provimeve eksterne të maturës shtetërore. Si përjashtim, nëse nuk konkurrojnë mjaft kandidatë, personat me më pak ose aspak përvojë do të merren parasysh në procesin e vlerësimit.

Kandidatët që konkurrojnë për **anëtarë të komisioneve lëndore të maturës shtetërore**, duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

- formularin e aplikimit të plotësuar (formulari i aplikimit është i vendosur në faqen e internetit: www.dic.edu.mk);
- biografi e shkurtër;
- certifikatën e shtetësisë;
- një kopje të certifikatës/diplomës për studime të kryera akademike të ciklit të parë në fushën përkatëse, e vërtetuar në noter;
- vërtetim se janë nga radhët e individëve profesional-mësimdhënës të lëndës përkatëse në shkollat e mesme ose fillore në RMV;
- vërtetim për të paktën 7 (shtatë) viteve përvojë në mësimdhënie dhe
- provë për të paktën 3 (tre) vjet përvojë në procesin e vlerësimit të provimeve eksterne të maturës shtetërore (aktvendim, kontratë ose vërtetim) në qoftë se ka.

Kandidatët që konkurrojnë për kryetarë dhe anëtarë të komisioneve lëndore të maturës shtetërore duhet të kenë përvojë në përgatitjen e materialeve të provimit.

Kandidatët për kryetarë dhe anëtarë të komisioneve lëndore të maturës shtetërore nuk duhet të kenë vëlla ose motër, djalë ose vajzë, nip ose mbesë nga: vajza, djali, vëllai, motra, vëllai ose motra e bashkëshortit/bashkëshortes, i cili/e cila është nxënës/nxënëse në vitin e IV të arsimit të mesëm, si dhe të mos jenë të lidhur përmes adoptimit ose kujdestarisë me një fëmijë që është nxënës/nxënëse në vitin e IV të arsimit të mesëm dhe që i nënshtrohet provimit përkatës në vitin shkollor aktual.

b) Kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët që konkurrojnë në konkursin publik për përzgjedhjen e bashkëpunëtorit të jashtëm – lexues i pavarur i materialit të provimit për maturën artistike shtetërore, si dhe dokumentacioni i detyrueshëm që ata duhet të dorëzojnë:

Kandidatët që konkurrojnë për pozitën e lexuesit të pavarur të materialit të provimit duhet t'i plotësojnë kushtet në vijim:

- të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- të kenë përfunduar së paku studimet akademike të ciklit të dytë në fushën përkatëse;
- të jenë nga radhët e stafit mësimor-shkencor ose profesional të universiteteve në RMV për lëndën, përkatësisht fushën përkatëse;
- të kenë së paku 5 vite përvojë pune në veprimtari edukativo-arsimore ose shkencore dhe
- të kenë të publikuara punime profesionale, përkatësisht shkencore, që lidhen me fushën përkatëse.

Kandidatët për **lexues të pavarur të materialit të provimit**, është e nevojshme t'i dorëzojnë dokumentet në vijim:

- formular aplikimi i plotësuar (formulari është i publikuar në faqen e internetit: www.dic.edu.mk);
- biografi e shkurtër;
- certifikatën e shtetësisë;
- kopje e certifikatës/diplomës për arsimin e lartë përkatës;
- kopje e certifikatës/diplomës për arsimin e ciklit të dytë në fushën përkatëse;
- vërtetim origjinal për marrëdhënie të rregullt pune si pjesë e stafit mësimor-shkencor ose profesional në universitetet e RMV-së për lëndën, përkatësisht fushën përkatëse, si dhe përvojë pune përkatëse prej së paku 5 vitesh në veprimtari edukativo-arsimore ose shkencore;
- kopje e faqes së parë të punimeve profesionale, përkatësisht shkencore të publikuara, që janë në funksion të fushës përkatëse.

IV. Qendra Shtetërore e Provimit do të kryejë një përzgjedhje sipas kritereve të mësipërme, kurse me kandidatët që plotësojnë kërkesat e specifikuara në konkurs do të zhvillohet intervistë, pas së cilës do të pasojë përzgjedhja përfundimtare.

Përzgjedhja e bashkëpunëtorëve të jashtëm bëhet në mënyrën dhe sipas procedurës së përcaktuar me Ligjin për Qendrën Shtetërore të Provimeve dhe Rregulloren për mënyrën, procedurën dhe kriteret për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm të Qendrës Shtetërore të Provimeve.

V. Kandidatët që do të zgjidhen kryetarë dhe anëtarë të komisioneve të lëndore të maturës shtetërore, si dhe kandidati që do të zgjidhet për lexues të pavarur të materialit të provimit, do të angazhohen deri në fund të vitit shkollor 2025/2026.

VI. Afati për aplikimin e kandidatëve të interesuar është deri më 10.02.2026.

VII. Përzgjedhja e bashkëpunëtorëve të jashtëm do të kryhet jo më vonë se 18 (tetëmbëdhjetë) ditë pas përfundimit të afatit të aplikimit.

VIII. Dokumentacioni i dërguar jashtë afatit, i paplotë dhe i pavlefshëm, nuk do të merret parasysh.

IX. Aplikimet me dokumentacionin e nevojshëm dorëzohet në Arkivin e Qendrës Shtetërore të Provimeve (nga ora 10:00 deri në ora 14:00) ose me postë rekomanduese, në adresën: Qendra Shtetërore e Provimeve - Shkup rr. "Vasil Gjorgov" p.n. 1000 Shkup, me shënimin "Për konkursin publik për bashkëpunëtorë të jashtëm - ..." (specifikohet se për çfarë aplikon dhe për çfarë lënde aplikon).

X. Informacione shitesë kandidatët e interesuar mund t'i marrin në numrin 075/284-335 (për kryetarë dhe anëtarë të komisioneve lëndore të maturës shtetërore), përkatësisht në numrin 076/484-739 (për lexuesin e pavarur të materialit të provimit), çdo ditë pune nga ora 10:00 deri në 14:00.

QENDRA SHTETËRORE E PROVIMEVE